



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 19243 prot.

Vlorë, më 17.11 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. 2025

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA E
BANESËS TË Z.VLLASI PROI DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E
BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Vllasi Proi, e ndodhur në lagjen “1 Maji”, Rajoni Nr4, Bashkia Vlorë, në datën 06.08.2025, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 159,972(njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë për punime ndërtimi (301,945x50%).

B.351,791(treqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika .

KRYETAR

Elis Halili

The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Elis Halili', written over a circular official stamp. The stamp is also in blue ink and contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' at the top and 'BASHKIA VLORE' at the bottom, with a central emblem of the Albanian coat of arms.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 19243 prot.

Vlorë, më 17.11 2025

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z.VLLASI PROI DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë datë 07.08.2025 ka paraqitur kërkesën z.Vllasi Proi me nr.13210prot. për shkak të djegies së banesës në datën 06.08.2024 e ndodhur në lagjen “1 Maji”, Rajoni Nr4, Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.26 datë 24.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 08.08.2025, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.13210/1 prot, datë 15.09.2025 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Vllasi Proi në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.13210/2 prot, datë 05.11.2025 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të z.Vllasi Proi”, ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

Vlera e dëmeve në banesën e z.Vllasi Proi është 511,763 (pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura. Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Vllasi Proi sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

DREJTOR

Jurian Mina

